

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. KLEANTHI ZEKA

11/22/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 20.11.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Kleanthi Zeka, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 22.11.2019, vendosi: Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Kleanthi Zeka, prokuror pranë Prokurorisë së Apelit Vlorë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Etleda Çiftja, znj. Firdes Shuli relatore, z. Roland Ilia anëtar, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.